REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# BASHKIA VLORË

## DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Nr. 7833 prot                                                                 Vlorë, më 23.04.2026

# PROJEKT-VENDIM

## "PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR"

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e datës____________.2026, bazuar në Ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", kreu III, pika 1.2, neni 54, pika e, neni 64, Ligjin nr.9693,datë 19.03.2007, "Për fondin kullosor", i ndryshuar, Ligjin Nr.7850, datë 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", VKM Nr.433, datë 08.06.2016 "Për trasferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish komunave/ Bashkive", VKM Nr.391, datë 21.06.2006 "Për caktimin e tarifave në sektorin pyjeve dhe kullotave", i ndryshuar; Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat dhe procedurat e kërkimit , shqyrtimite miratimit të kërjkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik"; Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr. 27 datë 27.02.2020 "Për miratimin e listës së inventarit të pasurive të paluajtshme pyje dhe kullota publike që kërkohen të transferohen dhe rregjistrohen në pronësi të Bashkisë Vlorë"; në kontratën e qirasë me Nr.4017 Prot., datë 03.04.2023 të lidhur mes qiradhënësit Bashkia Vlorë dhe Qiramarrësit Arsen Belaj; në kërkesën e bërë pranë Bashkisë Vlorë me Nr.3995 Prot., datë 26.02.2026.

## VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e subjektit Arsen Belaj për rinovimin e kontratës së marrjes me qira të sipërfaqes kullosore në pronësi "Shtet", të pasurisë me nr.66/1, Zona Kadastrale 1569, Fshati Dukat Fushë, me sipërfaqe 43000m$^2$ për një afat 15 vjet.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore".

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VLORË

**KRYETARE**

**Brunilda Mersini**

Adresa: Sheshi "4 Heronjtë", Tel: 033421201; Fax 033421201: ëëë.vlora.gov.al; e-mail: info@vlora.gov.al

R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Nr. 7833 prot                                                                 Vlorë, më 23. 4 2026

KËSHILLIT TË BASHKISË

RELACION:

**"PËR PROJEKT VENDIMIN PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR"**

**Të nderuar Këshilltarë!**

Sikurse jeni në dijeni, bazuar në Ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", kreu III, pika 1.2, neni 54, pika e, neni 64, Ligjin Nr.9693,datë 19.03.2007, "Për fondin kullosor", i ndryshuar, ligjin Nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", VKM Nr.433, datë 08.06.2016 "Për trasferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish komunave/ Bashkive", VKM Nr.391, datë 21.06.2006 "Për caktimin e tarifave në sektorin pyjeve dhe kullotave", i ndryshuar; Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit Nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat dhe procedurat e kërkimit , shqyrtimit të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik"; Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vlorë nr. 27 datë 27.02.2020 "Për miratimin e listës së inventarit të pasurive të paluajtshme pyje dhe kullota publike që kërkohen të transferohen dhe rregjistrohen në pronësi të Bashkisë Vlorë".

Subjekti Arsen Belaj, ka lidhur kontratën e qirasë me nr. 4017 prot., datë 03.04.2023 të lidhur mes qiradhënësit Bashkia Vlorë dhe Qiramarrësit Arsen Belaj; me objekt "Dhënie në përdorim të fondit pyjosor dhe kullosor publik", në kërkesën e bërë në Bashkinë Vlorë me Nr.3995 prot, datë 26.02.2026 nga ky subjekt.

Pas përfundimit të kontratës datë 03.04.2026, me kërkesë të subjektit, Nr. 3995 prot,. Datë 26.02.2026 i është drejtuar Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Bashkisë Vlorë e cila nëpërmjet specialistëve të saj, ka marrë në shqyrtim kërkesën dhe ka hartuar projekt vendimin përkatës për marrje me qira të kësaj sipërfaqe kullote për një afat 15 vjet.

Investimi i kryer nga subjekti me vlera financiare të cilat japin efekte për një periudhë kohore të gjatë, punimet e kryera bazë, si nivelime, plugime, frezime dhe mbjellje me drufrutorë të

cilët janë rrethuar sipas lejes së dhënë nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Vlorë, me Nr. 7700/1 prot., datë 03.06.2024. Gjatë periudhës së marrjes me qera subjekti ka qënë tatimpagues i rregullt i taksave dhe tarifave vendore për kontratën e parë me afat 3-vjeçarë për çdo vit.

Për shkak të investimit të kryer dhe vetë biologjisë së zhvillimit të drufrutorëve të mbjellë, subjekti kërkon zgjatjen e kontratës me qëllim investime të mëtejshme dhe marrjen e prodhimeve të pritshme për këtë investim.

Bashkëlidhur relacionit janë dokumentacionet e më poshtëme të vendosura në dispozicion nga kërkuesi dhe institucionet përkatëse.

1-Kopje e kërkesës së subjektit me nr.3995 prot., datë 26.02.2026

2-Kopje e kontratës 3-vjecare me nr.4017 prot.,datë 03.04.2023 të lidhur nga Bashkia Vlorë me subjektin Arsen Belaj, si dhe plan biznesi i subjektit për mbjelljen e drufrutorëve shumëvjeçarë (plan biznesi me objekt të kontratës së parë 3-vjeçare)

3-Kopje e shkresës me nr.3995/1 prot., datë 19.03.2026 të Bashkisë Vlorë

4-Konfirmim nga ASHK të gjendjes juridike të pasurisë objekt kontrate, lëshuar më 24.03.2026.

Për sa më lartë vendimmarrja juaj për këtë vendim, merret sipas Neni 54, pika e/1 të Ligjit Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

Ju faleminderit!

**DREJTOR**

**Bruna Bisholla**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË**
**DREJTORIA E PROTOKOLL-ARKIVËS**

**KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS**

**Dërgues** Arsen Belaj, **Nr.Prot.** ______ **Data** ____.____.2026

**Shkurtimi i lëndës** Kërkesë për rinovim të kontratës.

| | |
|---|---|
| **Për trajtim nga :** | Asitet |
| (struktura të tjera të ngarkuara | |
| **Me porosi:** | |

**Afati :** ☐ Normal 7 ditë/☐ Prioritet 3 ditë/☐ urgjent brenda ditës/☐ pa afat/në dije/Tjetër __ditë

**Data** 26-02 2026, **Nr. Prot.** 3995, **Nënshkrimi : ( TITULLARI)**

**Marrë në dorëzim :** ___.____. 2026 **Nënshkrimi :** ____________
**Kalon për trajtim ( struktura) :**____________________ ____.____.2026
**Me porosinë :** ________________________________________

**Marrë në dorëzim :** ___.____. 2026 **Nënshkrimi :** ____________
**Kalon për trajtim ( struktura) :**____________________ ____.____.2026
**Me porosinë :** ________________________________________

**Marrë në dorëzim :** ___.____. 2026 **Nënshkrimi :** ____________
**Kalon për trajtim Specialistit :**____________________ ____.____.2026
**Me porosinë :** ________________________________________

**Trajtimi i materialit përfunduar më :** ___.___2026 **Specialisti**
**Trajtimi i materialit pranuar më :** ___.___2026 **Eprori në shkallë hierarkike**
**Trajtimi i materialit miratuar më :** ___.___2026 **Eprori në shkallë hierarkike**
**Trajtimi i materialit miratuar më :** ___.___2026 **Eprori në shkallë hierarkike**

3995

26-02-2026

Kërkesë

Drejtuar: Bashkisë Vlorë

Unë i nënshkruari Arsen Beloj , banues ne Orikum , Bashkia Vlorë , paraqes kerkesën time si më poshtë:

Me Bashkinë Vlorë kam lidhur një kontrat Qiraje me nr.4017 prot., datë 03.04.2023 për një sipërfaqe kullote në pasurine me numër 66/1, zona kadastrale 1569, fshati Dukat Fushë. Këtë kontrat e kam lidhur sipas një planbiznesi që un kam zhvilluar duke e kthyer këtë kullotë në drufrutore. Afati i kësaj kontrate sipas nenit 4 të saj është 3 vjet me të drejtë përsëritje. Meqenese afati i kësaj kontrate përfundon më datë 03.04.2026, jam i detyruar që tju drejtohem në zbatim të ligjit për të përsëritur kontratën për një afat sa më të gjatë, për efekt te investimit që unë kam kryer në të. Kam kryer punime me vlera financiare të cilate japin efektin për një periudhë kohore relativisht të gjatë. Kam kryer punime bazë si nivelime,plugime, frezime dhe mbjellje me drufrutorë dhe e kam rrethuar sipas lejes së rrethimit të lëshuar nga Bashkia Vlorë.Kam qënë korekt me pagesën e taksave dhe tarifave vendore për këtë kontrat duke i kryer pagesat për cdo vitë sipas ligjit.

Ndodhur në këto kushte i drejtohem Bashkisë Vlorë ose Këshillit të kësaj Bashkie për paisjen me një kontrat të re me afat sa më të gjatë për arsye të ivestimit të kryer dhe të vet biologjisë së vet zhvillimit të drufrutorëve që unë kam mbjellë. Mundësisht afati i kontratës së re të jetë sa më gjatë që dhe unë të kem mundësi për investime të mëtejshme dhe marrjen e prodhimeve të pritëshme për këte investim.

Me respekt

Arsen Belaj

Vlorë më 23.02.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË**
**SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE**

Nr 4017 prot.

Vlorë, më 03.04.2023

# KONTRATE QIRAJE

*(Dhënie ne përdorim te fondit pyjor dhe Kullosor publik)*

***Ne zbatim te:***

- Ligjit nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*";
- Ligjit "*Për pyjet*", Ligjit 9693, date 19.03.2007 "*Për fondin kullosor*" i ndryshuar,
- Ligjit 7850, date 29.07.1994 "*Kodi Civil i Republikës se Shqipërisë*"...
- Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 433, date 08.06.2016 "*Për transferimin ne pronësi te bashkime te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrisë se Mjedisit dhe ish Komunave/ Bashkive*" te ndryshuar;
- Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 391, date 21.06.2006 "*Për caktimin e tarifave ne sektorin pyjeve dhe kullotave*" i ndryshuar
- Udhëzimit te Ministrit te Mjedisit nr. 1, date 09.06.2016 "*Për rregullat dhe procedurat e kërkimit, shqyrtimit e miratimit te kërkesave për dhënien ne përdorim te fondit pyjor dhe kullosor publik*";
- Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vlorë nr. 27 datë 27.02.2020 "*Për miratimin e listës së inventarit të pasurive të paluajtshme pyje dhe kullota publike që kërkohen të transferohen dhe rregjistrohen në pronësi të Bashkisë Vlorë*"

SEKRETARIA BASHKIA VLORË

Sot me date ____.____.2023 u lidh kjo kontrate qiraje ndërmjet palëve si me poshtë:

**QIRADHËNËSI:** Bashkia Vlore, e përfaqësuar nga Kryetari Z. Dritan Leli, shtetas shqiptar, (*në vijim referuar si* "**Qiradhënësi**")

*- nga njëra anë –*

**QIRAMARRËSI:** **Subjekti Arsen Belaj** regjistruar në regjistrin tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("**QKB**") me numër unik identifikimi të subjektit **M27115206F** me adrese Dukat, Njësia Administrative Orikum.

*- nga ana tjetër –*

*Palët e mësipërme, duke u bazuar ne legjislacionin ne fuqi dhe ne vullnetin e tyre te lire, bien dakord dhe vendosen te lidhin ketë Kontrate Qiraje si me poshtë vijon:*

**Neni 1**

**Objekti i Kontratës**

Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e sipërfaqes prej 43000 m2 sipas dokumentacionit bashkëlidhur kësaj kontrate që shtrihet brenda pasurise me nr 66/1, e regjistruar ne vol 1, fq 230, zk 1569.

**Neni 2**

**Qëllimi**

Kjo Kontrate ka per qellim dhënien ne përdorim te sipërfaqes pyjore e kullosore te përcaktuar ne Nenin 1 te kësaj Kontrate për ushtrimin e veprimtarisë se mbjelljes së bajameve ne sistemin intensiv sipas planit të biznesit bashkelidhur kësaj kontrate.

**Neni 3**

**Kushti Pezullues**

Kjo kontrate hyn ne fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët, mirëpo efektet e saj do te fillojnë ne momentin dhe vetëm nëse Qiramarrësi pajiset me Miratimin për Ndërtim nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (*miratimi përfundimtar për ndërtim*), sipas parashikimeve te Ligjit 43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*" dhe akteve përkatëse ligjore dhe nënligjore te dala ne zbatim te tij. Ne te kundërt kjo Kontrate do te konsiderohet si e palidhur asnjëherë me pare, e pavlefshme/nul.

Kontrata e lidhur mes palëve, pavarësisht se përfaqëson një marrëdhënie juridike me kusht pezullues, provon dhe garanton ekzistencën e një marrëdhënie juridiko-pronësie/posedimi me objektin e saj përcaktuar ne nenin 1 te saj.

## Neni 4

## Afati

1. Afati i dhënies ne përdormi është për një periudhe nga 6 muaj deri ne 3 vjet me te drejte ripërtëritje, ne zbatim te dispozitave ligjore ne fuqi dhe ne përputhje me grafikun e punimeve qe duhet te paraqesë shoqëria.
2. Afati dhe efektet e kësaj Kontrate për te dyja palët do te fillojnë me përmbushjen e kushtit te parashikuar ne nenin 3 me sipër.
3. Një (1) muaj përpara përfundimit te afatit te mësipërm, secila Pale duhet te njoftoje Palën tjetër për te negociuar shtyrjen e afatit te Kontratës për te njëjtën periudhe ose përfundimit respektiv te saj.
4. Ne mungese te një njoftimi ose komunikimi te tille midis Palëve, Kontrata do te konsiderohet e zgjidhur ne përfundim te afatit te saj te përcaktuar ne ketë nenë.

## Neni 5

## Vlera e Kontratës

Vlera totale e Qirasë vjetore, bazuar ne Raportin Teknik nr.6063, datë.30.05.2022 mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënien ne përdorim/heqje te sipërfaqeve te fondit pyjor dhe/ose kullosor ne pronësi publike te Bashkisë Vlore, hartuar nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor.

## Neni 5

## Pagesa dhe regjimi i saj

1. Pagesa e qirasë do te behet sipas kushteve te kësaj Kontrate, me fillimin e efekteve te saj, pas plotësimit te kushtit te përcaktuar ne nenin 3 te saj. Pagesa e pare do te behet te nesërmen e pajisjes se Qiramarrësit me Miratimin për ndërtim (*miratimi përfundimtar për ndërtim*).
2. Pagesat e tjera te përvitshme do to te kryhen ne datën/muajin/vitin pasardhës se pagesës se vitit te pare te hyrjes ne fuqi te Kontratës.
3. Pagesa e qirasë do te behet sipas vlerës së përcaktuar në raportin nr.6063, datë.30.05.2022 të Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave.
4. Vlera e qirasë është e pandryshueshme, përgjatë kohëzgjatjes se afatit te saj.
5. Ne rast se Qiramarrësi nuk do te kryejë pagesën sipas kushteve te vendosura me sipër, do te aplikohet kamatëvonesë prej 0.1% për çdo dite vonese, pro jo me shume se 10% te vlerës totale te pagesës përkatëse. Për efekt te llogaritjes se kamatëvonesave do te konsiderohen datat e përcaktuar ne ketë nene.

**Neni 6**

**Te drejtat dhe detyrimet e Qiradhënësit**

1. Qiradhënësi merr përsipër dhe i krijon Qiramarrësit mundësinë qe ta gëzoje dhe ta përdorë atë qetësisht ndaj pretendimeve te tretëve.
2. Qiradhënësi nuk përgjigjet për pretendime te tjera qe, nuk kane te bëjnë me sipërfaqen e dhëne ne përdorim, me objektin dhe qëllimin e Kontratës.
3. Qiradhënësi ka te drejte te kërkojë zgjidhjen e njëanshme te Kontratës kur Qiramarrësi nuk ka shlyen vlerën e qirasë sipas përcaktimeve te neneve 4 dhe 5 te kësaj Kontrate, dëmton rend ose nuk mirëmban e përmirëson sipërfaqen e marre ne përdorim, nuk përmbush detyrimet qe rrjedhin nga Kontrata, ato te përcaktuara ne planin e rehabilitimit dhe kushtet Lejes Mjedisore (*nëse Qiramarrësi ka detyrimin te pajiset me një te tille*) si dhe aktet ligjore dhe nënligjore ne fuqi qe rregullojnë veprimtarinë ne fushën e mjedisit, pyjeve dhe kullotave.
4. Qiradhënësi miraton planin e rehabilitimit te mjedisit pyjor objekt përdorimi, monitoron dhe merr ne dorëzim sipërfaqen pas rehabilitimit.
5. Monitoron ne vite detyrimet qe rrjedhin nga kontrata e përdorimit dhe kryerjen e procedurave ne terren gjate fazës se ndërtimit, përdorimit te sipërfaqes pyjore/kullosor dhe pyllëzimit sipas rastit.

SEKRETARI - BASHKIA VLORË

6. Qiradhënësi do te jete përgjegjës për zgjidhjen e çdo parregullsie ne objektin e dhënë me qira dhe qe pengon përdorimin normal nga Qiramarrësi, sipas fushës së tij të veprimtarisë.

## Neni 7

## Te drejtat dhe detyrimet e Qiramarrësit

1. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe plotësimin e kushtit te saj, Qiramarrësi ka te drejtë qe për te punësuarit e tij, agjentë, përfaqësuesit dhe çdo person tjetër qe Qiramarrësi i konsideron te përshtatshëm, te ketë te drejtën te hyje lirisht ne pronën objekt te kësaj Kontrate; te kryeje çdo veprim te cilin mund ta konsideroje te nevojshëm ose te dobishëm gjate ushtrimit te aktivitetit te tij; te transportojë mallra pajisje dhe materiale te tjera brenda sipërfaqes të marrë me qira; te bëje ndërtime te përkohshme ose te përhershme, si dhe punime te tjera ne përputhje me kërkesat e planit te rehabilitimit te sipërfaqes objekt përdorimi dhe kushteve te Lejes Mjedisore (*nëse Qiramarrësi ka detyrimin te pajiset me një te tille*) për ushtrimin e aktivitetit te saj.
2. Qiramarrësi nuk mund te transferoje te drejtën e siguruar nga kjo Kontrate për përdorimin e sipërfaqes se marre ne përdorim, te treteve, pa marre me pare miratimin nga Qiradhënësi.
3. Qiramarrësi nuk ka te drejtë te japë me nen-qira dhe te lidhe nen-kontraktime me subjekte te tjera apo t'ja kaloje Kontratën e lidhur një subjekti tjetër.
4. Qiramarrësi, do te kryeje me shpenzimet e veta, çdo punim mirëmbajtjeje qe do ti konsideroje te nevojshme ne sipërfaqen e marre ne përdorim.
5. Qiramarrësi do te përdorë sipërfaqen e marre ne përdorim me qëllim për te ushtruar aktivitetin qe përcaktohet ne nenet 1 dhe 2 te kësaj kontrate.
6. Qiramarrësi te mbroje dhe mire administroje sipërfaqen pyjore/kullosore ne përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 57/2020 "*Për pyjet*" dhe te Ligjit n.9693, date 19.03.2007 "*Për fondin kullosor*", te ndryshuar.
7. Qiramarrësi detyrohet te lejoje dhe te shoqërojë punonjësit e Ministrisë se Turizmit dhe Mjedisit dhe te Bashkisë Vlore te ushtrojnë kontrolle te arsyeshme per zbatueshmerine e kërkesave te përcaktuar ne Kontrate për sipërfaqen e fondit pyjor/kullosor te dhëne ne përdorim.
8. Qiramarrësi detyrohet te zbatoje çdo dispozite ligjore qe del e re ose ndryshim qe u behet atyre ekzistuese për pyjet, kullotat dhe gjuetinë.

9. Për çdo shkelje te konstatuar ne zbatim te pikave te mësipërme te Kontratës, zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 57/2020 "*Për pyjet*" dhe Ligjit n.9693, date 19.03.2007 "*Për fondin kullosor*", te ndryshuar.

10. Harton dhe miraton ne Bashkinë Vlore planin e rehabilitimit dhe ndjek zbatimin e tij.

11. Kryen pagesat e menjëhershme, pas fillimit te efekteve te Kontratës, te fondit pyjor dhe kullosor publik, për lenden drusore dhe pasuritë gjate kryerjes se punimeve dhe për vlerën e përdorimit te sipërfaqes për vitin e pare dhe ne vijim.

## Neni 8

## Detyrimet e përbashkëta te palëve

1. Ne përfundim te afatit te kësaj Kontrate ose ne përfundim te saj "*Qiramarrësi*" do te rehabilitoje sipërfaqen, për çdo dëmtim qe mund te jete shkaktuar gjate veprimtarisë dhe do t'a dorëzojë sipërfaqen e marre, siç ishte ne gjendjen fillestare përveç konsumit fizik normal.

2. Te gjitha njoftimet dhe komunikimet midis palëve do te behen me shkrim ne adresat e mëposhtme:

   ***Për Qiradhënësin Bashkia Vlore***

   Adresa: Lagjia 4 " Heronjtë"

   Email: bashkiavlorë@gov.al

   ***Për Qiramarrësin Arsen Belaj***

   Adresa: Dukat, Njësia Administrative Orikum, Vlorë

   Kontrata me kushtet dhe afatet e saj do të interpretohet si një e tërë. Në rast se ndonjë nen, paragraf, nën-paragraf dhe/ose frazë krijon paqartësi, interpretimi përkatës do të bëhet në përputhje me kontekstin e tërë Kontratës dhe sipas qëllimit për të cilën Palët e kanë lidhur të fundit.

3. Në rast se ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është e pavlefshme, e paligjshëm ose e pazbatueshme, atëherë kjo dispozitë do të veçohet. Pavarësisht nga kjo, të gjitha dispozitat e tjera të kësaj Kontrate do të mbeten në fuqi dhe të vlefshme. Asnjë dispozitë e kësaj Kontrate nuk do të varet nga dispozitat e tjera të saj, përveç kur është parashikuar ndryshe në Kontratë.

R- SEKRETARI - BASHKIA VLORE

## Neni 9

## Forca Madhore

1. Ne rast se ndonjë nga Palët e kësaj Kontrate pengohet te përmbushë te gjitha ose e pjese te detyrimeve te saj te parashikuara ne ketë Kontrate si pasoje e Forcës madhore, kjo pale nuk do te jete përgjegjëse për mospermbushjen e detyrimeve te saj gjate kohëzgjatjes se Forcës Madhore dhe për pasojat e shkaktuara dhe qe rrjedhin nga Forca Madhore.
2. Pezullimi i ekzekutimit te kësaj Kontrate si Pasoje e Forcës Madhore dot te kufizohet ne periudhën e kohës gjate te cilës vazhdojnë efektet e Forcës Madhore.

## Neni 10

## Zgjidhja dhe përfundimi i Kontratës

1. Efektet e kësaj Kontrate mbarojnë ne momentin e përfundimit te afatit te saj, përcaktuar ne nenin 4 me sipër.
2. Kontrata zgjidhet përpara përfundimit te afatit te saj, vetëm per shkak te ndryshimit dhe mosrespektimit te kushteve kontraktore, te moskryerjes se pagesës se qirasë ne afatin e caktuar dhe kushteve te te Lejes Mjedisore (*nëse Qiramarrësi ka detyrimin te pajiset me një te tille*) ose Vendimit te Ndikimit ne Mjedis.
3. Njoftimi për zgjidhjen e njëanshme te Kontratës behet me shkrim 15 dite përpara zgjidhjes se saj.
4. Kontrata behet menjëherë e pavlefshme kur është e pashoqëruar me hartën përkatëse te gjeoreferuar me koordinatat përkatëse. Parashikim i njëjti vlen edhe për çdo shtese apo amendim te saj qe prek objektin e saj.
5. Kontrata zgjidhet kur sipërfaqja e dhëne ne përdorim kërkohet për interesa publik te miratuara nga A.K.P.T.

## Neni 11

## Ligji i aplikueshëm dhe Gjykata kompetente

1. Kjo Kontratë hartohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, veçanërisht, por pa u kufizuar, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
2. Qiradhënësi dhe Qiramarrësi do të përpiqen që mosmarrëveshjet ndërmjet tyre t'i zgjidhin me bashkëbisedim dhe mirëkuptim. Në rast të kundërt, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata Administrative e Shkalles se Pare, Vlore.

**Neni 12**

**Dispozita e fundit**

1. Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë midis Palëve. Diskutimet verbale dhe parashtrimet e bëra gjatë negocimit për lidhjen e Kontratës nuk përbëjnë kushte të saj.
2. Çdo ndryshim në kushtet dhe afatet e parashikuara në këtë Kontratë do të jetë i vlefshëm vetëm nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja Palët ose nga përfaqësuesit e tyre.
3. Kjo Kontrate është e vlefshme vetëm ne hartën bashkëngjitur saj.
4. Ngarkohet për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj Kontrate, Bashkia Vlore, me ane te Drejtorisë se Shërbimit Pyjor, si strukture përgjegjëse për pyjet dhe kullotat.

Kjo Kontratë përpilohet në 4 (*katër*) kopje origjinale në gjuhen shqipe dhe 1(*një*) prej te cilave i jepet Qiramarrësit.

PER QIRAMARSIN

ARSEN BECIAJ

KRYETARI

Dritan Leli

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA VLORE

NJESIA ADMINISTRATIVE ORIKUM

KRYESIA E FSHATIT DUKAT FUSHE

DUKATE FUSHE me 30.11 2022 2022

Lenda: Shprehje dakortësie për dhënie me qera kullote.

**DPPMA –së të Bashkisë Vlorë**

**Bashkia Vlorë**

**Për dijeni: Z.Arsen Belaj**

Ne kryesine e fshatit Dukat Fushe është regjistruar kërkesa në emër te shtetasit Arsen Belaj shprehje dakortësie për marrje me qera të një sipërfaqe kullosore në teritorin e fshatit Dukat Fushë në parcelën me numër kadastral 66/1. Në kërkesën e bërë nga ky shtetas kërkohet që të kontratoj nga ana e Bashkis Vlorë një sipërfaqe kullosore , pronë e pretenduar e tyre e njohur me vendim gjyqi të formes se prere, por për të lidhur këtë kontratë DPPMA –ja e Bashkië Vlorë i kërkon shprehjen e dakortësisë nga ana e kryesisë së fshatit Dukat Fushë.

Referuar informacioneve që kemi dhe njohurive si kryesi fshati parcela me nr. Pasurie 66/1 në fshatin Dukat Fushë është tërësisht në pronën e pretenduar të fisit Beloj.

Në këto kushte shprehim dakortësin që kjo pjesë kullote brenda pronës së pretenduar të fisit Beloj ti kontratohet nga ana e Bashkisë Vlorë shtetasit Arsen Belaj , për ta marr me qera.

KRYETARI I FSHATIT

DUKAT FUSHE

(Foto Gjipali)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË NJESIA ADMINISTRATIVE KRYETARI I FSHATIT DUKAT ORIKUM BASHKIA VLORË

# PLANVENDOSJE

**PËRGATITI**

EMRI ---------GJEODET RASIM VEIPI
NR.LICENSES-------T.0298/3
DATA E LESHIMIT- 18-11-2016
DATA E PERGATITJES---- 18-01-2024

RASIM VEIPI
LICENSE
T.0298/3

**PIKETIMI I PRONËS SË MARRË ME QERA NGA Z.ARJAN & ARSEN BELO ,NË FSHATIN DUKAT FUSHË,VLORË ME NR.PASURIE 66/1 & SIP.43000 M² OSE4.3 HA**

SHKALLA 1: 2500




**KOORDINATAT UTM**

1–384205.7507,4475124.9347
2–384148.6174,4475069.1208
3–384098.4294,4475059.4689
4–384055.4692,4475037.5381
5–384018.2998,4474991.4080
6–383961.2264,4474989.9076
7–383888.2600,4474965.1797
8–383890.2361,4475133.6774
9–383960.2740,4475208.6689
10–384024.0799,4475233.6437
11–384065.8282,4475154.2185
12–384088.6964,4475166.2233
13–384085.2961,4475151.7920
14–384067.7108,4475138.2964
15–384023.7509,4475088.6625
16–384061.9192,4475068.1496
17–384123.1530,4475114.8001
18–384130.0797,4475138.6658
19–384166.2733,4475143.4244
20–384183.4217,4475148.5954

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# BASHKIA VLORË

## DREJTORIA E URBANISTIKËS

Nr. 7700/1 prot. Vlorë, më 03.06 2024

Lënda: Dërgim informacioni

**Z.Arsen Belaj**
**Nr.cel. 0683292036**
**Orikum Vlorë**

**Për dijeni**: Inspektoriatit Të Mbrojtjes Së Territorit

Në përgjigje suajës nr. 7700 prot, datë 22.05.2024 me lëndë "Kërkesë për leje punimesh", referuar kontratës së qirasë ju informojmë si më poshtë:

Në bazë të VKM Nr.457, datë 29.06.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave,"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" të ndryshuar, po ju dërgojmë informacion për punimet të cilat nuk kan nevojë për pajisje me leje ndërtimi si më poshtë vijon:

1. Ndërhyrje të mirëmbajtjes së zakonshme, sipas nenit 2, të kësaj rregulloreje, që përfshijnë:
1.1 ndërhyrje të jashtme për riparimin dhe zëvendësimin e rifiniturave të jashtme të ndërtesave, me kusht që të ruhen karakteristikat origjinale të tyre, si:
x. sistemimi i oborreve;
xii. riparimi i rrethimeve ekzistuese.

**KRYETAR**

**Ermal Dredha**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VLORË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE ASHK VLORE

**Date _03_2026**

**Lënda:** *Kthim-përgjigje*

**Drejtuar:** **Z.Arsen Belaj**

Në përgjigje të aplikimit tuaj Nr.**37429**, date 15.09.2025, me objekt "Informacion zyrtare ",

Bashkelidhur shkreses po ju vendosim ne dispozicion Gjendjen Juridike sipas kerkeses tuaj .

Duke ju falenderuar per mirekuptimin !

| Nr | Identifikimi I pasurise/veekzistuesembitecilen/at pozicionohetprona e cilatrajtohetnga Komisioni vendor/KomitetiShteteror | | | | | | | Gjendjajuridike e pasurise/veekzistuesembitecilen/at pozicionohetprona e cilatrajtohetngakomisioni Vendor /KomitetiShteteror | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Zona KADASTRALE | Numri I Pasurise | Vol. Fq. | Indeksi I HTR | Adresa e Pasurise | Lloji i Pasurise | Siperfaqja(m2) Totale NgaSip.Tot: Sa truall NgaSip.Truall: Sa Ndertese | PronesiambiPasurine (Seksioni C I Karteles se Pasurise) | Tedrejtatet jerarealembiPasurine (Seksioni D I Karteles sePasurise) | KufizimembiPasurin e (Seksioni E I Karteles se Pasurise) |
| 1 | 1569 | 66/1 | V-1 F-230 | K-34-135 | Dukat | Kullote | TOT=582150 m2 Truall---- Ndertese M2 | Shtet | | |

DREJTOR
Albion Koçi

Eliverta Cobaj — Digitally signed by: Eliverta Cobaj Date: 2026.03.24 10:28:53 +02'00'

Albion Koci — Digitally signed by: Albion Koci Date: 2026.03.24 08:31:05 +02'00'

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Vlorë
Date:2026/03/24 10:30:57 +02'00'
H01214099Q2026032410305074014

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Vlorë)*

**FATURË PËR ARKËTIM**

Me anë të kësaj fature kërkojmë që B.K.T DEGA VLORË të pranojë nga klienti per llogari të institucionit tonë, me emërtime , kode, numër identifikimi dhe shuma si më poshtë.

**Emri I Institucionit përfitues** BASHKIA VLORË

**Kodi I Institucionit përfitues** 2146001

**Kodi I Degës së Thesarit ku vepron** 1010037

**Emri I paguesit ( /person fizik/person juridik) Blumar Skele**

**Numri I Indentifikimit të Paguesit**____

| ID e Detyrimit | Përshkrimi I të ardhurave Emërtimi | | Shuma që arkëtohet (Lekë) |
|---|---|---|---|
| | Taksë tokë bujqësore | 7020100 | |
| | Taksë ndërtese | 7020200 | |
| | Taksë tabele | 7035009 | |
| | Taksë ndricimi | 7035099 | |
| | Taksë pastrimi | 7110501 | |
| | Taksë zënies hapsires publike | 7035099 | |
| | Taksë tregu | 7035002 | |
| | Taksë regjistrimi | 7035001 | |
| | Taksë hoteli | 7035005 | |
| | Taksë reklame | 7035008 | |
| | Taksë veterinarie | 7035099 | |
| | Taksë qera toke | 7109200 | |
| | Taksë qera ndertese | 7109600 | |
| | Biznes | 7002100 | |
| | Gjoba | 7115499 | |
| | Ujësjellësi | 7035099 | |
| | Kullote | 7035030 | 4.3 ha x 3400 l/ha/vit |
| | Debitor | 7111099 | = 14620 l/vit |
| | Të tjera | 7035099 | |
| | Taksë trualli | 7020600 | |
| | **SHUMA** | | 14.620 l |

**Përfaqësuesi institucionit**
**Bashkia Vlore**

(Person Fizik/Person **Juridik** )
**Arsen Belaj**

Banka Kombetare Tregtare 03-OCT-2023 10:48

TE ARDHURA PER DEGET E THESARIT

KLIENTI / CUSTOMER : 408000843
EMRI / NAME : WALKIN CUSTOMER
ADRESA / ADRESS : VLORA

REFERENCA / REFERENCE : 408ATHD232760012
DATE VALUTA / VALUE DATE : 03-OCT-23

NUMRI I FATURES / BILL NO : 0
DATA E FATURES / BILL ISSUE DT : 03-OCT-23
NR IDENTIFIKUES / IDENTIFICATION NO : 0
SHUMA E FATURES / BILL AMT : 14,620.00 ALL

PERSHKRIMI I VEPRIMIT :
Kodi Thes.: 3737 Kodi Argn.: 7035030 Kodi Inst.: 2146001
ARSEN BALAJ DERDH PER BASHKIA VLORE PER KOLLOTE

SHERBIMI / SERVICE ID : DEGA THESAR VLORE
TIPI I PAGESES / PAYMENT TYPE : CAS
LLOGARIA E VEPRIMIT / TXN ACC : BA1112000 ALL
DEBI / DR ACC :
EMERTIMI I LLOGARISE / ACC DESC : BKT
KREDITUAR / OFS ACC : 408279532OLTHESALLAE ALL
TRAN / CR ACC : AL91 2052 5087 2795 320L THES ALLA TE ARDHURAT E THESARIT, INSTITUCIONE BUXHETORE

KURSI I KEMBIMIT/EXCH RATE :

PERMBLEDHJE E KOMISIONIT / CHARGE / TAX SUMMARY

KOMISION : 300.00 ALL

SHUMA NETO/NET AMT : 14,920.00 ALL

KODI I STAFIT / ST CODE: EALUSHI

KLIENTI : EMER MBIEMER FIRME ARSEN BALAJ

Une konfirmoj me nenshkrimin e ketij mandati se te dhenat e printuara jane te sakta sipas kerkeses time. Ky mandat do te sherbeje si prove per cdo pretendim ne te ardhmen.

********** Sipas Kushteve të Punës në fuqi **********

Punonjesi i deges: Vula:

14920

BKT VLORE
03-10-2023
N 205/28027

| PRERJA | SASIA | VLERA |
| --- | --- | --- |
| | 5 / | 500 |
| | | 80 |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |

Banka Kombëtare Tregtare 15-OCT-2024 14:39

TE ARDHURA PER DEGET E THESARIT

KLIENTI / CUSTOMER : 408000843
EMRI / NAME : WALKIN CUSTOMER
ADRESA / ADRESS : VLORA

REFERENCA / REFERENCE : 408ATHD242890057
DATË VALUTA / VALUE DATE : 15-OCT-24

NUMRI I FATURËS / BILL NO : 0
DATA E FATURËS / BILL ISSUE DT : 15-OCT-24
NR IDENTIFIKUES / IDENTIFICATION NO : H01214099Q
SHUMA E FATURËS / BILL AMT : 14,620.00 ALL

PËRSHKRIMI I VEPRIMIT :
Kodi Thes.: 3737 Kodi Ardh.: 7035030 Kodi Inst.: 2146001
ARSEN BELAJ ID H01214099Q DERDH PER BASHKIA VLORE KULLOTE

SHËRBIMI / SERVICE ID : DEGA THESAR VLORE
TIPI I PAGESËS / PAYMENT TYPE : CAS
LLOGARIA E VEPRIMIT / TXN ACC : BA1112000 ALL
IBAN / DR ACC :
EMËRTIMI I LLOGARISË / ACC DESC : BKT
KREDITUAR / OFS ACC : 408279532OLTHESALLAE ALL
IBAN / CR ACC : AL91 2052 6087 2795 32OL THES ALLA
TE ARDHURAT E THESARIT INSTITUCIONE
BUXHETORE

KURSI I KËMBIMIT/EXCH RATE :

PËRMBLEDHJE E KOMISIONIT / CHARGE / TAX SUMMARY

| | | |
|---|---|---|
| KOMISION | : | 300.00 ALL |
| SHUMA NETO/NET AMT | : | 14,920.00 ALL |

KODI I STAFIT / ST CODE: ARIELAS

KLIENTI : EMËR MBIEMËR FIRMË ------------------------------

Unë konfirmoj me nënshkrimin e këtij mandati se të dhënat e printuara janë të sakta sipas kërkesës time. Ky mandat do të shërbejë si provë për çdo pretendim në të ardhmen.

++++++++++ Sipas Kushteve të Punës në fuqi ++++++++++

| PRERJA | SASIA | VLERA |
|---|---|---|
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |

Punonjësi i degës: Vula:

DEGA VLORE 15-10-2024 F 205/28087

Banka Kombëtare Tregtare

10-DEC-2025 14:30:34

TE ARDHURA PER DEGET E THESARIT

| | |
|---|---|
| KLIENTI / CUSTOMER : | 408000843 |
| EMRI / NAME : | WALKIN CUSTOMER |
| ADRESA / ADRESS : | VLORA |
| REFERENCA / REFERENCE : | 408ATHD253440010 |
| DATË VALUTA / VALUE DATE: | 10-DEC-2025 |
| NUMRI I FATURËS / BILL NO: | 0 |
| DATA E FATURËS / BILL ISSUE DT | 2025-12-10 |
| NR IDENTIFIKUES / IDENTIFICATION NO | 0 |
| SHUMA E FATURËS / BILL AMT : | ALL 14,620.00 |

PËRSHKRIMI I VEPRIMIT :

ARSEN BELAJ DERDH PER BASHKIA VLORE KULLOTE INS 2146001 TH 37 TA 7035030

| | |
|---|---|
| SHËRBIMI/ SERVICE ID: | DEGA THESAR VLORE |
| TIPI I PAGESËS / PAYMENT TYPE: | CASH |
| LLOGARIA E VEPRIMIT / TXN ACC : | BA1112000 |
| EMËRTIMI I LLOGARISË / ACC DESC : | BKT |
| KREDITUAR / OFS ACC : | 408279532OLTHESALLAE |
| IBAN / CR ACC: | AL91205260872795320LTHESALLA |
| EMËRTIMI I LLOGARISË / ACC DESC : | TE ARDHURAT E THESARIT INSTITUCIONE BUXHETORE |
| KURSI I KËMBIMIT/Exchange Rate : | 1.00 |

PËRMBLEDHJE E KOMISIONIT / CHARGE / TAX SUMMARY

| | |
|---|---|
| KOMISION : | ALL 300.00 |
| SHUMA NETO / NET AMT : | ALL 14,320.00 |
| KODI I STAFIT/ ST CODE : | IGJIKONDI |

| PRERJA | SASIA | VLERA |
|---|---|---|
| L1000 | 15 | 15000 |
| L50 | -1 | -50 |
| L10 | -1 | -10 |
| L5 | -4 | -20 |

KLIENTI : EMËR MBIEMËR FIRMË ____________________

Unë konfirmoj me nënshkrimin e këtij mandati se të dhënat e printuara janë të sakta sipas kërkesës time. Ky mandat do të shërbejë si provë për çdo pretendim në të ardhmen.

L 205 / 26087
10 DEC 2025
BKT VLORE
Punonjësi i degës

Sipas Kushteve të Punës ne fuqi *********

Arsen Belaj

Vula:

| PRERJA | SASIA | VLERA |
|---|---|---|
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA VLORE

NJESIA ADMINISTRATIVE ORIKUM

KRYESIA E FSHATIT DUKAT FUSHE

DUKATE FUSHE me 30.03 2026

Lenda: Shprehje dakortësie për dhënie me qera kullote.

**DPPMA –së të Bashkisë Vlorë**

**Bashkia Vlorë**

**Për dijeni: Z.Arsen Belaj**

Ne kryesine e fshatit Dukat Fushe është regjistruar kërkesa në emër te shtetasit Arsen Belaj shprehje dakortësie për marrje me qera të një sipërfaqe kullosore në teritorin e fshatit Dukat Fushë në parcelën me numër kadastral 66/1. Në kërkesën e bërë nga ky shtetas kërkohet që të kontratoj nga ana e Bashkis Vlorë një sipërfaqe kullosore , pronë e pretenduar e tyre e njohur me vendim gjyqi të formes se prere, por për të lidhur këtë kontratë DPPMA –ja e Bashkië Vlorë i kërkon shprehjen e dakortësisë nga ana e kryesisë së fshatit Dukat Fushë.

Referuar informacioneve që kemi dhe njohurive si kryesi fshati parcela me nr. Pasurie 66/1 në fshatin Dukat Fushë është tërësisht në pronën e pretenduar të fisit Beloj.

Në këto kushte shprehim dakortësin që kjo pjesë kullote brenda pronës së pretenduar të fisit Beloj ti kontratohet nga ana e Bashkisë Vlorë shtetasit Arsen Belaj , për ta marr me qera.

KRYETARI I FSHATIT

DUKAT FUSHE

(Foto Gjipali)

REPUBLIKA E SHQIPERISE NJESIA ADMINISTRATIVE KRYETARI I FSHATIT DUKAT ORIKUM BASHKIA VLORE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

**NUMRI SERIAL: 41260120101**

41260120101

# ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI

*Personit të Tatueshëm:*
Fermer "Arsen Belaj"

*Me adresë kryesore:*
Dukat Fushe, Dukat Fushe

*I jepet ky numër identifikimi (NIPT/SSN):*
M66524331V

**Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë**

**DATA E LËSHIMIT:** 24.03.2026

**DREJTORI**

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore
Date:2026/03/24 13:13:26 +02'00'
c198054e921d4a40a3f78e8785704dd2

Kjo çertifikatë është pronë e Ministrisë së Financave dhe duhet të kthehet në qoftë se ka ndryshime në detaje ose nuk ka më detyrime ligjore për të qenë person i tatueshëm.

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore)*

Nr 461 prot
Dt 21.04.22.

**KËRKESË**

**Drejtuar:** Bashisë Vlorë.

Unë i nënshkruari Arsen Belaj, banues në Orikum, Bashkia Vlorë, paraqes kërkesën time si më poshtë:

Kërkoj që në parcelën Nr. 66/1 që ndodhet në Zonën Kadastrale 1569 në Dukat Fushë, Bashkia Vlorë, të marr 4.3 ha tokë me qira, për të ngritur një biznes familjar. Ky biznes sot konsiderohet shumë premtues dhe i kërkuar.

Për këtë qëllim, i kërkoj Bashkisë Vlorë, si autoriteti qiradhënës që ka në përdorim tokën për të cilën jam i interesuar, të më japë me qira sipërfaqen e kërkuar, në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr.8318, datë 1.4.1998 "Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetërore" (i ndiyshuar) dhe VKM Nr460 datë 22.5.2013 "Per percaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave te dhenies me qira te tokave bujqesore ne pronesi te shtetit".

Shpresoj që kërkesa ime të merret në konsideratë nga ana juaj.

**Me respekt**
**Arsen Belaj**

# PLAN BIZNESI

**AKTIVITETI:** Mbjellje Bajame në sistem intensiv

**Adresa:** Dukat Fushë, Bashkia Vlorë

**Kërkuesi:** Arsen Belaj

## 1-Historik i shkurtër i Aktivitetit:

Në bazë të procedurës që është hapur nga Basbkia Vlorë për manjen e tokave me qera shpreh interesin për të marrë me qera 43000 $m^2$ tokë në Dukat Fushë, Bashkia Vlorë me qëllim zhvillimin e aktivitetit bujqësor mbjelljen e drufrutorëve (Bajame në sistem intensiv), si një biznes familjar me prespektivë agroturizmi. Tokat për të cilën bëhet fjalë nuk ka pretendues. Për mbjellje do të përdoren fidanë të çertifikuar, të shtuar me nënshartesa vegetative që kufizojnë rritjen dhe nxisin fntjen e hershme të bimës në prodhim. Disavantazhi i saj është jetëgjatësia e pemëtores (mesatarisht 15 vjet), por prodhimtaria e lartë dhe hershmëria e saj e justifikon aplikimin e këtij sistemi.

***Shtrirja gjeografike ,***

Toka e cila dëshirojmë të marim me qera ka një shtrirje gjeografike në zonën e Dukat Fushë, Bashkia Vlorë, ndodhet në zonën kadastrale 1569, me numër pasurie 66/1 dhe ka një sipërfaqe totale 43000 $m^2$ (4.3 ha). Bashkëlidhur është planimetria e saj.

***Ambjenti,*** është i përshtatshëm për zhvillimin e veprimtarisë që synojmë të aplikojmë. Kemi kushte dhe sipërfaqe të mjaftueshme për zhvillimin e një aktiviteti të suksesshëm.

***Sigurimi,*** ambjenti ku ne duam të zhvillojmë aktivitetin do të rrethohet për të siguruar nga faktorë të jashtëm, ndërkoh që do sigurohet për mbrojtjen nga dëmtime të mundshme si zjarri, eksplozioni, vjedhjaetj.

## Projekti **Teknik** i mbjellies

Ky lloj biznesi sot konsiderohet shumë premtues dhe i kërkuar. Pavarësisht konkurrencës së madhe, ajo ka një kthim të mirë të investimit. Si kulturë bajamja shkon mirë me kushtet mjedisore të zonës. Do të aplikojmë sistem intensive të kultivimit.

Toka ndodhet në pjerrtësinë 5-15%.

Përbërja e tokës: argjilore e mesme

Reaksioni i tokës (pH): Asnjanës

Në gjatësinë 360 ml në drejtim lindje-perëndim do të ndërtohen kanalet antieroziv për të pritur ujërat e larta .

Kullimi do të bëhet çdo15- 20 m me kanale të hapur dhe drenazhimi në thellesi 60-80 cm.

Tokat ku do të kultivohet bajamja, nga ana agronomike është shumë e përshtatshme kjo dhe si rrjedhojë e historisë që ka pasur kjo zonë në kultivimin e këtyre kulturave

Mënyra e mbjelljes së fidanit do të jetë në distancën 5 m larg rrjeshti nga rrjeshti dhe 2 m larg bima nga bima.

Para mbjelljes do të bëhet nivelimi dhe sistemimi i të gjithë sipërfaqes.

Punimi qilizëm do të bëhet në thellësinë 60-65 cm me traktor .

Më pas do të bëhen diskimet dhe frezimet e nevojshme.

Para plugimit do të hidhen 1200 kv/ha pleh organik dhe 24 kv/ha plehra kimike ndërsa në kohën e mbjelljes do të hidhen 200 kv/ha pleh organiuk dhe 6 kv/ha plehra kimike.

Gjatë 2 viteve të para, ndërkohë që pemëtorja nuk është shumë e rritur, do të aplikohet mbjellja e hapësirës ndërmjet rreshtave me kultura të tjera perimore të kërkuara në treg. Kjo mënyrë organizimi minimizon koston e shpenzimeve në vitet e para, duke përfituar nga punimet e bëra për ngritjen e pemëtores. Këto kultura kanë cikël të shkurtër dhe fitimi nga to është më i shpejtë, njëkohësisht mbjella e tyre do të minimizojë kostot e shërbimeve për mirëmbajtjen e pemëtores dhe rreziqet nga faktorët ekstreme mjedisore .

**Analiza financiare për zhvillimin e tokës**

Kostua e realizimit të mbjelljes për këtë sipërfaqe shkon 5 530 000 lekë, e ndarë si më poshtë:

Rrethimi me tel gabion 420 000 lekë,

Sistemim dhe nivelim parcelës 120 000 lekë,

Punim qilizëm dhe plugim i zakonshëm 258 000 lekë,

Frezime dhe diskime 258 000 lekë,

Fidana 2 250 000 lekë,

Pleh organik 700 000 lekë,

Plehra kimike 240 000 lekë,

Punime për mbjellje dhe shërbime në vitin e parë 437 000 lekë.

Sistemi ujites .600 000

Shpenzime të tjera direkte 114 000 lekë

**Analiza dhe përparësitë:**

Cmime të volitshme të shitjes së produktit,

Produkt cilësor e favorizuar nga kushtet mjedisore dhe zgjedhja e kultivarëve,

Produkte me përmbajtje krejtësisht natyrale,

Produkte që nuk kanë konkurrencë të lartë pasi nuk gjenden në gjithë territorin e zonës tonë,

Blerja online përmes internetit

Dobësitë

Kostoja e lartë e investimit fillestar, mjetet që na nevojiten kanë kosto shumë të lartë ,

Makineritë e vjeljes dhe zhveshjes/thyerjes janë shtrenjta,

Mundësitë

Shfrytëzimi i turizmit dhe agroturizmit për shitje direkt në fermë,

Paketimi i produkteve në mizura të ndryshme,

Zgjerimi i mekanizimit brenda një kohe të caktuar,

Rritja e numrit të punëtorëve.

**Studimi i tregut dhe tregu kufi**. Pas një studimi të bërë, ne arritëm në përfundim që miniferma familjare e sapokrijuar, do të prodhojë produkt cilësor, sepse e favorizojnë kushtet mjedisore dhe investimi i duhur për një të tillë.

**Analiza e konkurrencës dhe cmimeve**.Si cdo biznes tjetër, edhe biznesi në të cilin duam të investojmë ne, ka konkurrentë. Biznesi ynë ka përparësi konkurruese dhe të qëndrueshme në raport me konkurrentët për shkak të njohurive që ne kemi, ekspertëve që na mbështesin dhe të teknologjisë që do të aplikomë, veçanërisht në përzgjedhjen e kultivarit. Konkurrentët tanë të drejtë për drejtë do te jenë banorët e zonës. Ne gjithmonë do të përpiqemi që të ofrojmë produkte cilësore, por gjithnjë duke i'u përshtatur cmimeve të tregut dhe duke ofruar cmime të përshtatshme për konsumatorët tanë.

**Pozicionin në treg.** Bajamja sikurse arrorët e tjera kanë një kërkesë shumë të lartë në tregjet e eksportit si pasojë e përdorimit të tyre të gjerë në industrinë e përpunimit, tek çokollatat, ëmbëlsirat, etj. Miniferma jonë ka si qellim te pozicionohet e para dhe më të mira në tregun aktual duke ofruar produkte krejtësisht cilësore dhe të sigurta për të gjithë. Edhe pse është një minifërmë e re në treg, me njohjet dhe aftësitë menaxhuese tona do të bëjmë që të jetë më e preferuara dhe e besuara nga konkurrentët e saj.

**Strategjia e cmimit/Politika e cmimit.**Miniferma, do të ndjekë politikën e cmimeve konkurruese, duke përdorur teknologji bashkëkohore të avancuara për uljen e shpenzimeve të saj, por edhe duke u përshtatur me çmimet që ofron tregu. Cmimet janë të përshtatshme dhe ndonjëherë do të ketë oferta, p.sh produkte me çim të diferencuar sipas sasisë apo dhe gratis blej 2 merr 1 gratis. Kur ka çmime promocionale shitet më shumë pasi ato gjithnjë janë të mirëpritura nga konsumatorët.

**Strategjia dhe plani i shitjes.**Ne kemi menduar se për të arritur objektivat dhe qëllimet tona, duhet të kemi një strategji dhe një plan të shitjes,i cili për të qenë i suksesshëm duhet shumë punë. Produktet gjenden në të gjitha qytetet e Shqipërisë, dhe duke u ofruar në dyqane si dhe markete pasi në këtë mënyrë ne do të mund të jemi më pranë konsumatorëve. Për t'ua lehtësuar punën e blerjes së produkteve tona, ne kemi menduar edhe shtjen online përmës internetit, e cila konsiderohet edhe përparësi kundrejt konkurrentëve tanë. Internetin dhe promocionin do ta shfrytëzojmë për aplikimin edhe të një forme shitje direkt në fermë duke lejuar klientët të përfitojnë në çmim nëse marrin pjesë në vjeljen e prodhimit.

**Plani i promocionit dhe reklamës.** Reklama është në një mënyrë edhe suksesi i minifermës, sepse produkti duhet treguar tregut për të provuar dhe për të vlersuar ata vetë produktin. Ne mendojmë që promcionin e produktit ta bëjmë përmes reklamave televizive, billborde, në rrjetet sociale të cilat tanimë janë shumë të përdorura nga e gjithë bota, p.sh facebook, Instagram etj, broshurat e ndryshme etj,. Po ashtu për të mbajtur konsumatorët aktual dhe për të tërhequr konsumatorë të rinjë, ne përdorim strategjinë me produkte gratis.

**Analiza dhe Plani Financiar** . Kultivimi i bajameve në forma intensive kanë marzhe të larta fitimi, sepse zakonisht kanë nevojë për një numër të ulët shërbimesh dhe kanë çmime relativisht të larta. Analiza më e hollësishme jepet në Tabelat 1,2 dhe 3.

**Investimet dhe Shpenzimet.**

Për ta filluar investimin, miniferma ka nevojë për 5 530 000 lekë, të cilat i siguron nga investimet e veta familjare dhe nga kredi bankare. Shpenzimet të cilat kemi janë : Shpenzimet për blerjen e fidanave, Shpenzimet e pagave, Shpenzimet e internetit, Shpenzimet e reklamave , Shpenzimet e energjis elektrike, Shpenzime të tjera etj janë pasqyruar në mënyrë të detajuar në Tabelën 2.

